

RELACION TEKNIK

Shkolla 9 vjecare “ 28 NËNTORI”

**"STUDIM PROJEKTIM I PUNIMEVE PËR MIRËMBAJTJEN E
THELLË NË HIDROIZOLIMIN E TARRACAVE NË OBJEKTET
ARSIMORE DHE GODINA PUBLIKE 2024, FAZA 1"**

Hartuar nga:

NET-GROUP sh.p.k

Përmbajtja

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME	3
GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT	4
PROPOZIMI PËR MIRËMBAJTJEN E THELLË TË OBJEKTEVE	6
TARRACA T1	7
TARRACA T2	11
TARRACA T3	14
TARRACA T4	16
TARRACA T5	18
TARRACA T6	19
PËRFUNDIME:	20
<i>Fig. 1 Pozicionimi i objektit</i>	<i>3</i>
<i>Fig. 2 Ortofoto</i>	<i>3</i>
<i>Fig. 3 Foto ambientet e brendshme</i>	<i>4</i>
<i>Fig. 4 Foto gjendja ekzistuese e tarracës</i>	<i>5</i>
<i>Fig. 5 Tarraca 1</i>	<i>7</i>
<i>Fig. 6 Tarraca 1 Gjendja ekzistuese</i>	<i>7</i>
<i>Fig. 7 Kafazi i shkallës T1</i>	<i>8</i>
<i>Fig. 8 Shtresat e tarracës së propozuar T1</i>	<i>9</i>
<i>Fig. 9 Detaj i tarracës mbi kafazin e shkallëve</i>	<i>10</i>
<i>Fig. 10 Tarraca T2</i>	<i>11</i>
<i>Fig. 11 Tarraca T2 Gjendja ekzistuese</i>	<i>11</i>
<i>Fig. 12 Detaji i hidroizolimit të fugës mes objekteve</i>	<i>12</i>
<i>Fig. 13 Shtresat e tarracës së propozuar T2</i>	<i>13</i>
<i>Fig. 14 Tarraca T3</i>	<i>14</i>
<i>Fig. 15 Tarraca T3 Gjendja ekzistuese</i>	<i>14</i>
<i>Fig. 16 Shtresat e tarracës së propozuar T3</i>	<i>15</i>
<i>Fig. 17 Tarraca T4</i>	<i>16</i>
<i>Fig. 18 Tarraca T4 Gjendja ekzistuese</i>	<i>16</i>
<i>Fig. 19 Detaji i shtresave të propozuara T4</i>	<i>17</i>
<i>Fig. 20 Tarraca T5</i>	<i>18</i>
<i>Fig. 21 Tarraca T5 Gjendja ekzistuese</i>	<i>18</i>
<i>Fig. 22 Tarraca T6</i>	<i>19</i>
<i>Fig. 23 Tarraca T6 Gjendja ekzistues</i>	<i>19</i>

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Objekti i marrë në studim është shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori”. Ky objekt ndodhet në Njësinë Administrative Nr. 11, në Rrugën “Dritan Hoxha”. Objekti përbëhet nga godina 1, 2 dhe 3 katëshe, të ndërtuara në periudha të ndryshme. Në këtë objekt arsimor zhvillojnë procesin arsimor rreth 1000 nxënës.



Fig. 1 Pozicionimi i objektit




Fig. 2 Ortofoto

GJENDJA EKZISTUESE E OBJEKTIT

Objekti i marrë në studim projektim është Shkolla 9-Vjeçare "28 Nëntori". Ky objekt ka probleme me lagështinë që vjen nga tarracat. Pavarësisht ndërhyrjeve mirëmbajtëse që janë kryer, lagështia nuk është eliminuar, por vazhdon të jetë prezentë veçanërisht gjatë periudhës së rreshjeve dhe është e përqëndruar kryesisht në fugat e bashkimit të objekteve. Nga inspektimet e kryera në terren dhe vërejtja në vend e situatës, shihet që lagështia vjen nga soletat, të cilat nuk kanë hidroizolim, e kanë të dëmtuar ose kanë hidroizolim të pjesshëm. Lagështia sjell edhe rënien e suvasë së tavaneve dhe mureve, duke krijuar një ambient jo të sigurt për zhvillimin e mësimin dhe sigurinë e jetës së nxënësve. Përveç shtresave hidroizoluese të tarracës të cilat janë të amortizuara, dëmtime kanë edhe ulluqet të cilët janë të amortizuar, sidomos në pjesën e sipërme të tyre dhe në disa raste edhe mungojnë. Zgjidhja e problematikës mund të arrihet vetëm duke ndërhyrë në tërësi me mirëmbajtje të thelluar.

Prezenca e lagështirës në ambientet e brendshme:



Fig. 3 Foto ambientet e brendshme

Në fotot e mëposhtme paraqitet gjendja ekzistuese e tarracës së objektit:




Foto T1



Foto T2



Foto T3



Foto T4



Foto T5



Foto T6



Foto Palestra

Fig. 4 Foto gjendja ekzistuese e tarracës

PROPOZIMI PËR MIRËMBAJTJEN E THELLË TË OBJEKTEVE

Pas analizës së gjendjes ekzistuese të tarracave të shkollës “28 Nëntori”, u arrit në konkluzionin që është e nevojshme ndërhyrja për mirëmbajtjen e thellë të tyre.

Qëllimi kryesor është përmirësimi i kushteve në ambientet e brendshme të shkollës, gjë e cila sjell dhe përmirësimin e standarteve të mësimdhënies. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet riparimeve dhe mirëmbajtjes së thellë të shtresave hidroizoluese të tarracës, duke aplikuar materiale bashkëkohore dhe me standarte më të larta. Ndërhyrja do të sjellë eliminimin e lagështirës nga muret dhe tavanet e shkollës si dhe reduktohet humbja e energjisë së brendshme të objektit nëpërmjet soletës së tarracës.

Në mënyrë të përgjithshme ndërhyrja konsiston në kryerjen e këtyre proceseve të punës:

- Do të realizohet prishja e shtresave ekzistuese të llustër-çimento dhe të shtresës hidroizoluese karton katrama, prishja e kapuçave ekzistues të parapeteve, çmontimi i rrufepritësve, transportimi dhe largimi i inerteve.

- Mbi shtresat ekzistuese do të aplikohet një shtresë termoizoluese me polisterol me trashësi 5 cm.

- Mbi shtresën e polisterolit do të hidhet një shtresë me llustër çimento 4 cm.

- Aplikim i dy shtresave hidroizoluese me karton katrama dhe shtrimi me një shtresë llustër çimento me trashësi 4 cm për mbrojtjen e shtresave hidroizoluese.

- Rikualifikimi i sistemit të kullimit të ujërave të shiut nëpërmjet zëvendësimit të kasetave të shkarkimit dhe ulluqeve vertikale ekzistues të amortizuar dhe shtim të ulluqeve ku është e nevojshme.

- Riparimi i elementeve të fugaturave mes volumeve ndërtimore, hidroizolimi i tyre si një pikë e dobët depërtuese e lagështirës në objekt.

- Në fugat e takimit të palestrës me objektet ngjitur vërehet prezencë lagështire, e cila vjen si rezultat i bllokimit të ulluqeve. Për eliminimin e saj propozohet pastrimi i ulluqeve të kullimit dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e tyre.

Rrufepritësit do të çmontohen për kryerjen e punimeve në tarracë dhe në përfundim ato do të montohen me gjithë aksesorët sërish në pozicionet e mëparshme.

Hartimi i këtij projekti është realizuar në përputhje me të gjitha normat dhe standartet e projektimit si dhe standartet e zbatimit.

Ndërhyrjet specifike po i paraqesim më poshtë:

TARRACA T1




Fig. 5 Tarraca 1

Tarraca T1 pozicionohet mbi objektin 3-katësh. Kjo tarracë pozicionohet mbi objektin me sipërfaqe më të madhe. Sipërfaqja e tarracës është 645.9 m² dhe tarraca që mbulon kafazin e shkallëve me sipërfaqe 53.1 m². Tarraca është e pashfrytëzueshme, shtrimi është në gjendje jo të mirë dhe nevojitet ndërhyrje për hidroizolimën e saj. Parapeti është i lartë 70 cm.



Fig. 6 Tarraca 1 Gjendja ekzistuese

Ndërhyrja konsiston në prishjen e shtresave ekzistuese dhe realizimin e shtresave të reja sipas detajit më poshtë. Kapucat e parapetit ekzistues do të çmontohen dhe do të mbulohet parapeti me kornizë llamarine. Do bëhet zëvendësimi i ulluqeve të kullimit dhe kasetave ekzistuese të amortizuara për të përmbushur standartet për kullimin e ujërave të tarracave.

Mbi soletën e kafazit të shkallëve do të ribëhen shtresat si dhe do të ndërtohet një parapet i ulët me mur për të sistemuar kullimin e ujërave të shiut. Mungesa e një parapeti bën që uji të rrjedhë në faqen e murit të fasadës dhe depërton në brendësinë e objektit.

Do të bëhet zëvendësimi i pllakave të dëmtuara prej gips çimentato të faqes së murit dhe do të bëhet lyerja e tyre me bojë plastike RAL 9010.



Fig. 7 Kafazi i shkallës T1




Fig. 8 Shtresat e tarracës së propozuar T1




Fig. 9 Detaj i tarracës mbi kafazin e shkallëve

TARRACA T2




Fig. 10 Tarraca T2

Tarraca T2 pozicionohet mbi objekt 2 katësh. Sipërfaqja e tarracës është 338 m².

Tarraca është e pashfrytëzueshme, shtrimi është në gjendje jo të mirë dhe nevojitet ndërhyrje për hidroizolimimin e saj. Parapeti është i lartë 35 cm.



Fig. 11 Tarraca T2 Gjendja ekzistuese

Ndërhyrja konsiston në prishjen e shtresave ekzistuese dhe realizimin e shtresave të reja sipas detajit më poshtë. Kapuçat e parapetit ekzistues do të çmontohen dhe do të mbulohet parapeti me kornizë llamarine. Do bëhet zëvendësimi i ulluqeve të kullimit dhe kasetave ekzistuese të amortizuara për të përmbushur standartet për kullimin e ujërave të tarracave.

Në faqen e fugës me objektin 3-katësh është propozuar veshja e parapetit me shtresë hidroizoluese 2 k katrama e cila do të perfundojë në nivelin e dritares kurse në murin mes tyre do të ngrihet deri në 20 cm. Mbi shtresën hidroizoluese me karton katrama do të bëhet mbyllja me kapuç llamarine në mënyrë për të penguar depërtimin e lagështirës në bashkimin mes 2 volumeve të objektit.




Fig. 12 Detaji i hidroizolimit të fugës mes objekteve





Fig. 13 Shtresat e tarracës së propozuar T2

TARRACA T3




Fig. 14 Tarraca T3

Tarraca T3 pozicionohet mbi objekt 2 katësh. Sipërfaqja e tarracës është $112.7 m^2$. Tarraca është e pashfrytëzueshme, shtrimi është në gjendje jo të mirë dhe nevojitet ndërhyrje për hidroizolimim e saj. Parapeti është i lartë 55 cm.



Fig. 15 Tarraca T3 Gjendja ekzistuese

Ndërhyrja konsiston në prishjen e shtresave ekzistuese dhe realizimin e shtresave të reja sipas detajit më poshtë. Kapucat e parapetit ekzistues do të çmontohen dhe do të mbulohet parapeti me kornizë llamarine. Do bëhet zëvendësimi i ulluqeve të kullimit dhe kasetave ekzistuese të amortizuara për të përmbushur standartet për kullimin e ujërave të tarracave.





Fig. 16 Shtresat e tarracës së propozuar T3

TARRACA T4




Fig. 17 Tarraca T4

Tarraca pozicionohet mbi objekt 2 katësh. Sipërfaqja totale e tarracës është 480.1 m², e ndarë në 2 zona nga 1 parapet dhe kanë sipërfaqe respektivisht T4 - 354.2 m² dhe T4/1 - 125.9 m². Tarraca është e pashfrytëzueshme, shtrimi është në gjendje jo të mirë dhe nevojitet ndërhyrje për hidroizolimimin e saj. Parapeti është i lartë 50-70 cm.




Fig. 18 Tarraca T4 Gjendja ekzistuese

Ndërhyrja konsiston në prishjen e shtresave ekzistuese dhe realizimin e shtresave të reja sipas detajit më poshtë. Kapucat e parapetit ekzistues do të çmontohen dhe do të mbulohet parapeti me kornizë llamarine. Parapeti që ndan 2 sipërfaqet e tarracës do të vishet me shtresë hidroizoluese karton katrama në mënyrë të vazhdueshme pa pësuar shkëputje në mënyrë që mos krijohen fuga nga ku mund të depërtojë lagështira.

Do bëhet zëvendësimi i ulluqeve të kullimit dhe kasetave ekzistuese të amortizuara për të përmbushur standartet për kullimin e ujërave të tarracave.





Fig. 19 Detaji i shtresave të propozuara T4

TARRACA T5




Fig. 20 Tarraca T5

Tarraca pozicionohet mbi objekt 1 katësh. Tarraca është e shfrytëzueshme dhe në të janë realizuar punime mirëmbajtjeje, është kryer hidroizolimi me shtresë karton katrama dhe pas këtyre ndërhyrjeve është zgjidhur problemi i lagështirës. Gjithashtu në fugat e takimit me objektet e tjera është bërë veshja me llamarinë e murit për te penguar depërtimin e lagështirës. Parapeti është i lartë 110 cm dhe kapuçi është veshur me kornizë llamarine. Në këtë tarracë nuk është parashikuar të ndërhyet, për arsye se ajo nuk shfaq problematika prej hidroizolimit.



Fig. 21 Tarraca T5 Gjendja ekzistuese

TARRACA T6



Fig. 22 Tarraca T6

Tarraca pozicionohet mbi objekt 1 katësh. Tarraca është e shfrytëzueshme dhe në të janë realizuar punime mirëmbajtjeje, është kryer hidroizolimi i tarracës dhe pas këtyre ndërhyrjeve është zgjidhur problemi i lagështirës. Parapeti është i lartë 110 cm dhe kapuçi është veshur me kornizë llamarine. Në këtë tarracë nuk është parashikuar të ndërhyet, për arsye se ajo nuk shfaq problematika prej hidroizolimit.



Fig. 23 Tarraca T6 Gjendja ekzistues

PËRFUNDIME:

Zbatuesi i punimeve duhet ti përmbahet specifikimeve teknike dhe punimet të kryhen sipas detajeve të paraqitura në projekt dhe specifikimeve teknike.

Çdo dimension duhet të verifikohet në terren.

Kostoja totale e punimeve është e përcaktuar në preventivin përfundimtar të objektit, hartimi i të cilit është realizuar duke u bazuar në projektin e zbatimit, specifikimet teknike dhe njëkohësisht duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Autoritetit Kontraktor në lidhje me standartet e pranuar. Çmimet e referencës janë sipas legjislacionit në fuqi të marra në Manualin Teknik të Çmimeve të Ndërtimit ose në mungesë të tij në analiza referuar studimit të tregut.

Për çdo ndryshim në detaje, shtresa apo specifika të veçanta, zbatuesi i punimeve duhet të konsultohet me përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor dhe duhet të marrë miratimin e tij për ndryshime në projekt.